








# Zbulo Hasin - Udhërrëfyes Turistik







**BASHKIA HAS**

**ZYRA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE TURIZMIT**

**2025**

# Mirë se vini në Has!

Në pjesën verilindore të Shqipëris, Hasi mbetet një nga thesaret më të fshehura të natyrës dhe kulturës shqiptare, njohur për mikpritjen e saj dhe bukuritë e paprekura, kjo zonë është destinacioni i përsosur për ata që kërkojnë aventurë, qetësi dhe autenticitet.






# Rreth Bashkisë Has

- 📍 **Vendndodhja**: Në skajin verilindor të Shqipërisë, Hasi kufizohet me Kosovën dhe ndodhet vetëm pak kilometra nga Prizreni dhe Kukësi.
- ⛰️ **Relievi**: Zonë kryesisht malore me peizazhe të thepisura dhe natyrë të virgjër ,pjesë e Alpeve Lindore.
- 👥 **Popullsia**: Rreth 21,000 banorë, me komunitet që ruan zakonet dhe mënyrën tradicionale të jetesës.



**Pozita strategjike**: Portë natyrore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës e përshtatshme për turizëm kulturorë dhe aventurier.
**Kultura**: Veshje, këngë epike dhe mikpritje autentike, pasuri që ruhen me krenari brez pas brezi.



# Atraksionet Natyrore

- Mali i Pashtrikut
- Shpella e Pëllumbave
- Shpella e Dajçit
- Gurra e Domajve
- Pisha e Gjinajve
- Pisha e Liqenit të Kuq
- Bjeshka e Krumës, etj.

# Kultura & Trashëgimia

"Në Has, kultura nuk është vetëm kujtim - është mënyra se si jetohet ende sot."



- 🏛️ **Kullat tradicionale** - simbol i historisë dhe organizimit familjar të zonës, disa prej tyre ende banohen nga pasardhësit e familjeve të vjetra.
- 🎶 **Këngët epike** - trashëgimi e rrallë që përshkruan trimërinë, nderin dhe jetën në malësi.
- 👘 **Veshjet popullore të Hasit** - punime të dorës me ngjyra të pasura, të trashëguara brez pas brezi, të përdorura në dasma dhe festa tradicionale.
- 🪘 **Ritet, zakonet dhe besimet lokale** - ruajnë karakterin autentik të shoqërisë malësore dhe lidhjen me natyrën.
- **Artizanati lokal** - punime me lesh, drurë dhe guri që shiten në tregje tradicionale apo gjatë festave.

# Ushqimi Tradicional

"Në Has, ushqimi nuk është vetëm traditë është dashuri e shtruar në sofër."










- Pitja e Hasit.
- Flija.
- Pula me qervish dhe oriz.
- Kuleqët e nuses.
- Pasul me mish të thatë, (fasule me pasterma) e zier në (veksh) enë prej balte, në formë vorbe.
- Lankur.
- Oriz me tamel (qumësht)
- Mishi dhe djathi i dhisë kuqe autoktone, e zën me mullez.
- Kaqimaki.
- Buka e kallamoqit (misrit) e pjekur në qerep.

Këto janë disa nga gatimet e shijshme që ofron tradita e Hasit.

# Aktivitetet Turistike

"Has nuk është vetëm një vend që vizitohet - është një përvojë që jetohet."



**Ecje malore (hiking)**
Shtigje të bukura në malin e Pashtrikut, Bjeshkën e Krumës, apo nëpër pyje e livadhe të qeta.

🏕️ **Kamping në natyrë**
Ambient i pastër dhe i qetë për kamping veror me pamje spektakolare.

📸 **Fotografi e peizazhit dhe natyrës së egër**
Momente unike për të kapur bukurinë e paprekura të veriut shqiptar.

🐑 **Përvoja në fermat lokale**
Ndihmo në mjeljen e bagëtive, prodhimin e djathit, ose mëso rreth jetës së përditshme fshatare.

**Eksplorim kulturor**
Vizitë në kullat historike, pjesëmarrje në dasma ose festa tradicionale.

🍂 **Turizëm sezonal**
Zbuloni magjinë e çdo stine!
Gjatë **vjeshtës**, natyra fton vizitorët të marrin pjesë në **grumbullimin e arrave dhe barishteve aromatike**, duke përjetuar traditat vendase dhe shijet e stinës.
Në **pranverë**, peizazhi gjallërohet me ngjyra dhe aroma - një periudhë ideale për **ecje në shtigjet malore** dhe për të admiruar **çeljen e mrekullueshme të luleve alpine**.

# Mali Pashtrik




Pashtriku është zona malore më e rëndësishme e Hasit, e vendosur në kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës me lartësi 1989 m, shtrihet në skajin më VL të kesaj malësie, midis pellgut të Krumës në VP, luginës së Drinit të Bardhë në JL dhe Hasit të Thatë në Rafshin e Dukagjinit në VL (jashtë kufirit shtetëror). Është i ndërtuar tëresisht prej gëlqerorësh te mesozoit. Maja e tij ka forme tipike konike me lartim relativ 700 - 800 m mbi pllajën karstike të Hasit. Qafa e Mullarëve në VP e ndan nga Maja e Kunorës (1513 m). Gjithë shpati P,J dhe pjesa më e madhe e shpatit VP janë thuajse krejtësisht të zhveshura. Shpati V dhe ai L janë të veshur me bimësi (dushk,ah).

# Pse duhet ta vizitosh Malin e Pashtrikut?

- 🏞️ **Panoramë magjepsëse 360°**
  Nga maja sheh Shqipërinë dhe Kosovën njëherësh: Prizrenin, Kukësin, Gjakovën, liqenin e Fierzës dhe malet përreth të shfaqen si në një pikturë.
- **Në kufi të legjendës dhe realitetit**
  Një mal simbolik që ndan jo vetëm dy shtete, por bashkon kultura, histori dhe legjenda të përbashkëta.
- 🌺 **Bota e egër e ruajtur si thesari i Alpeve**
  Strehë për dhjetëra lloje bimësh dhe kafshësh të rralla, nga shqiponja e artë te lulet endemike që gjenden vetëm këtu.



🧘‍♂️ **Frymë shpirtërore dhe pelegrinazh**
Një vend i shenjtë ku takohen shqiptarë nga gjitha trevat në rastin e pelegrinazhit në këtë mal të shenjtë.
🚶 **Shteg për çdo aventurier**
Një ecje 7- 8 orëshe përmes natyrës së virgjër, me vështirësi mesatare dhe shpërblim maksimal "pamje, qetësi dhe adrenaline".
🌍 **Në prag të një statusi të ri: Park Kombëtar!**
Mali dhe zona përreth pritet të shpallen Park Kombëtar, duke u kthyer në një destinacion model për ekoturizmin në rajon.
📜 **Histori dhe kujtesë kolektive**
I njohur edhe si vend simbol i luftës së vitit 1999, Mali mbart histori njerëzore që nuk shuhen kurrë.




- Shtegu më i shkurtër per të arritur në Malin Pashtrik është nga fshati Cahan,

Ky shtegë është i aksesushëm vetëm me këmbë mbasi që nuk ka rrugë makine, rruga makinës arrin vetëm deri në fshatin Cahan e cila është e pa asfaltuar rekomandohen makina për terrene malore. Ky shteg është ideal për ata që preferojnë Hiking. Me makinë mund të arrihet vetëm nga Kosova përkatsisht intenerari: Prizeren - Gjonaj - Milaj - Varri i Poshtëm.


Selami Kastrati










Burimi i Krumës i njohur nga banorët si vrella e Krumës ndodhet në pjesën juglindore të qytetit  të Krumës, në lartësinë 480m mbi nivelin e detit. Përbën një burim të madh karstik që del në rrezen e një rrëpire, në kontaktin tekniko - litologjik midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe molasës kuaternale. Ka prurje 600 l/sek, dhe ujë të pastër. Vizitohet me lehtësi sipas intinerarit qyteti i Kukësit - qyteza e Krumës.

# Gurra Domajve



Gurra e Domajve ndodhet në afërsi të fshatit Domaj Bashkia Has, në lartësinë 400 m mbi nivelin e detit. Përbën një burim të madh karstik që del në kontaktin tekniko-karstik të gëlqerorëve te Kretës së sipërme dhe terrigjenëve. Ka prurje mbi 300 l/sek dhe ujë të pastër dhe të ftohtë. Krijon një mjedis shumë tërheqës. Ka vlera shkencore ( gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike ), kulturore, didaktike dhe turistike.














# Ahishta Liqenit të Kuq

Ahishta e Liqenit të Kuq ka një sipërfaqe prej 12 hektarësh dhe ndodhet pranë fshatit Liqeni i Kuq, në një lartësi prej 300 - 370 metrash mbi nivelin e detit, buzë liqenit të Fierzës. Ky është një pyll ahu (Fagus sylvatica), i cili rritet shumë më poshtë se sa lartësia tipike ku zakonisht gjendet ky lloj druri në Shqipëri (mbi 1000 metra mbi nivelin e detit). Kjo e bën zonën të veçantë dhe tepër interesante nga pikëpamja ekologjike.
Drurët e ahut arrijnë lartësi prej 25 - 28 metrash, me diametër trungjesh nga 35 deri në 57 cm dhe moshë që varion nga 80 deri në 150 vjet.









# Shpella Pëllumbave

Shpella e Pëllumbave ose e(Shpella e 3 Dritareve) ndodhet 1300 metra mbi nivelin e detit, në vargmalin e Pashtrikut, mes fshatrave Vlahen, Dobrune, Nikoliq dhe Greçinë. E rrethuar nga pyje të dendura dhe një bimësi e larmishme, zona është shumë tërheqëse në pranverë dhe përdoret shpesh për ekskursione. Shpella mbetet e paeksploruar plotësisht, por paraqet interes të veçantë për natyrën dhe misterin që ofron

Përbën një shpellë karstike. Është e gjatë mbi 30m, e gjerë deri në 11 m dhe e lartë 5 m. Në të kalojnë natën shpend të ndryshëm por më shumë pëllumbat e egër prej te cilave ka marrë emrin. Shpella ka konkrecione të shumta dhe vlera shkencore.




Shtegu për të arritur tek shpella e pëllumbave, arrihet vetëm në këmb, rruga më e shkurtër dhe më e lehtë për të arritur është nga fshati vlahën lagjia muhadri. Koordinatat  42°15'53.01"N ; 20°27'54.33"E



Pisha e Gjinajt ndodhet rreth 700 metra mbi nivelin e detit dhe është e njohur për veçantinë e saj, pasi përbën një nga pishat më të veçanta dhe më të vjetra në Shqipëri. Ajo është një pemë monumentale afro 300 vjeçare, lartesi mbi 20 metra dhe trung mbi 1 m.









# Liqeni - “Fshati Zahrisht”

Fshati Zahrish ka një potencial të madh turistik falë liqenit dhe natyrës që e rrethon.




Selami Kastrati







# Xhamia Fshatit Tregtan



Xhamia është ndërtuar me stil të thjeshtë, por të hijshëm, duke ruajtur elemente të arkitekturës islamike tradicionale shqiptare me moshë mbi 300 - vjeçare. E vendosur në afërsi të rrugës kryesore të fshatit, është e lehtë për t'u vizituar gjatë një itinerari në zonën e Hasit.

# Fshati Cahan



Fshati Cahan ndodhet në një lartësi mbi 1100 metra mbi nivelin e detit. Ai është shpallur nga qeveria shqiptare si një nga 100 fshatrat turistikë, duke u vlerësuar për bukurinë e tij natyrore, traditat e pasura dhe potencialin për zhvillimin e turizmit rural.

Me peizazhin mahnitës, natyrën e paprekur, klimën e freskët dhe mikpritjen e banorëve, Cahan është vendi ideal për t'u shkëputur nga zhurma dhe rutina e jetës urbane.

# Gadishulli në lumin Drin - përballë fshatit Metaliaj - pikë panoramike



# Kulla Kurpalëve

Kulla e Kurpalëve në Letaj, Has, është një monument kulture, ndërtuar rreth 150 vite më parë nga bijtë e Kurpalit. Ajo ka qëndruar ndaj kohërave të vështira dhe sot është një muze i hapur që pasqyron historinë, traditën dhe krenarinë shqiptare. Vizitorët mund të shohin nga afër arkitekturën e saj dhe të njohin jetën tradicionale dhe ngjarjet historike që lidhen me këtë kullë, një simbol i gjallë i identitetit të Hasit.



Nga **qyteti i Krumës**, ndiqet rruga në drejtim të **fshatit Letaj**, që ndodhet rreth **14 km larg**. Rruga është e kalueshme me automjet dhe shoqërohet me pamje të bukura natyrore të Hasit.

**KONTAKTO:**

info@bashkiahas.gov.al
Adresa: "Deshmoret e Hasit" Sheshi ,Pjeter Bogdani Pallati I Kulturës, Qyteti Krumë.